



Agjencioni për Financim në Kosovë  
Agency for Finance in Kosovo  
Agencija za Finansiranje na Kosovu



GREEN FOR GROWTH FUND  
SOUTHEAST EUROPE

INVESTING IN ENERGY EFFICIENCY  
AND RENEWABLE ENERGY

## BASHKËPUNIM I GGF-IT ME AFK-N PËR PËRKRAHJE TË FINANÇIMIT TË GJELBËRT NË KOSOVË

- GGF depërton në tregun e 14-të me 1 milion Euro kredi, investim i parë i këtij lloji në Kosovë
- Parashihet që masat për efikasitet të energjisë (EE) të financuara nga kredia e GGF të rezultojnë në kursimin primar vjetor të energjisë deri në 500 MWh si dhe në zvogëlimin e emitimit të CO2 për 200 ton metrik në vit.

**Luksemburg dhe Pejë, Kosovë, 13 Tetor 2016** – Fondi për rritje të gjelbërt, (GGF) sot ka njoftuar për lëshimin e kredisë në vlerë prej 1 milion euro për Agjencionin për Financim në Kosovë (AFK), me një marrëveshje që zgjeron dhe diversifikon me tej shtrirjen në fushën gjeografike dhe operacionale të Fondit, me financimin e zhvillimit të tregut të Energjisë Efiçente (EE) në Kosovë.

Duke i shërbyer bizneset mikro dhe të vogla, si dhe komunitetin rural, AFK e ka kuptuar rëndësinë e financimit në Efikasitet të Energjisë dhe potencialin në rritje të këtij sektori. Investimi është dizajnuar për të përkrahur dëshirën e AFK për të ritur financimin të dedikuara për EE, dhe kredia e parë e GGF-it në Kosovë paraqet mundësitë e Fondit për të financuar masat për reduktimin e shfrytëzimit të energjisë në tregjet e reja. Nga AFK pritet që investimin e GGF ta shpërndaj tek klientet, me qëllim të zvogëlimin të përdorimit të energjisë dhe emitimit të CO2 nga ana e amvisërive familjare dhe bizneseve. Së bashku me kredin, GGF i ofron AFK's edhe asistencë teknike me qëllim zgjerimin e njohurisë dhe ekspertizës të AFK-s në dhënien e kredive për Efikasitet Energjetike.

Kryetari i Bordit i Fondit GGF, z.Christopher Knowles tha: “ Bashkëpunimi ynë me AFK dëshmon edhe një herë përkushtimin tonë për zgjerim. Me rritjen e numrit të tregjeve ku ne ofrojmë fonde për zvogëlimin e konsumimit të energjisë dhe emitimit të CO2, Fondi GGF vazhdon rrugëtimin drejt arritjes së objektivave të tij.”

Drejtori Ekzekutiv i AFK, z.Vahdet Anadolli tha: “Ne ndihemi të lumtur dhe të privilegjuar të jemi IMF e parë në Kosovë që do të marrim mbështetje financiare dhe asistencë teknike nga Fondi GGF. AFK tani ka një eksperiencë të dëshmuar në financimin e EE në Kosovë, dhe këto Fonde të reja, do të na mundësojnë që të promovojmë edhe më tej vlerat dhe përkushtimin tonë në mbrojtje të ambientit.



Agjencioni për Financim në Kosovë  
Agency for Finance in Kosovo  
Agencija za Finansiranje na Kosovu



GREEN FOR GROWTH FUND  
SOUTHEAST EUROPE

INVESTING IN ENERGY EFFICIENCY  
AND RENEWABLE ENERGY

## RRETH FONDIT GGF

Fondi për rritje të gjelbër është i përkushtuar që të kontribuoj në zvoglimin e shfrytëzimit të energjisë dhe emetimit të CO2 në minimum 20% në 19 vende të Evropës Juglindore, përfshirë Kaukazin, Ukrainen, Moldavine, Lindjen e Mesme dhe Afriken Veriore. Fondi ofron financim të institucioneve financiare që kreditojnë ndërmarrjet dhe bizneset familjare, dhe në mënyrë të drejtëpërdrejt financojnë projekte për energji eficiente dhe energji të ripërtitëshme. Departamenti i Asistencës Teknike të GGF ofron perkrhaje në ngritjen e kapaciteteve institucioneve lokale dhe partnerëve. Fondi GGF është themeluar si partneritet publiko-privat në dhjetor të vitit 2009 nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW dhe Banka Evropiane për Investime me perkrhaje financiare nga Komisioni Evropian, Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, dhe Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindertim, Banka për Zhvillim e Austrisë OeEB. Baza në rritje e investitoreve të përkushtuar përbehet nga agjencionet donatore, institucionet financiare ndërkombëtare dhe investitor të institucioneve private, siç janë Kooperata Ndërkombëtare Financiare IFC, Kompania Holandeze e Zhvillimit Financiar FMO Banka Etike Gjermane GLS dhe Kisha e Suedisë. Fondi GGF menaxhohet privatisht nga Oppenheim Asset Management Services S.s.r.L., Luksemburg, dhe këshilluar nga Finance in Motion GmbH. MACS Management & Consulting Services GmbH, Frankfurt/Main operon si këshilltar teknik. Për më tepër informacion shikoni në: [www.ggf.lu](http://www.ggf.lu)

## RRETH AFK

Agjencioni për financim në Kosovë (AFK) është themeluar në tetor të vitit 2000 si program zhvillimor i financuar nga Mercy Corps, OJQ me bazë në SHBA, me misionin që të përmirësojë kushtet e jetesës në Kosovë duke ofruar qasje në shërbime të qëndrueshme financiare për mikrondërmarrje dhe ndërmarrje të vogla. Në shkurt të vitit 2002 AFK është rregjistruar si OJQ Fondacion pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike. Njëherit AFK është licencuar nga BQK si Institucion Mikrofinanciar (IMF). AFK është një ndër themeluesit e Shërbimit Informativ kreditor në Kosovë (KCIS) si dhe të Shoqatës së Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës (AMIK) që ka për qëllim promovimin e praktikave më të mira dhe standardeve të industrisë.

Nga Zyra Qendrore e AFK -s e vendosur në qytetin e Pejës dhe 17 degë të shpërndara në tërë territorin e Kosovës AFK ofron kredi për individët me të hyra të ulëta të cilët kanë qasje të limituar ose nuk kanë fare qasje në fonde komerciale.

Deri me datën 30 Qershor 2016, AFK ka disbursuar 65,000 kredi në vlerë prej 121 milion Euro, nga të cilat 49% e kredive janë dhënë në zonat rurale ndërsa 51% e kredive janë dhënë në zonat peri-urbane dhe urbane në Kosovë.

Për më tepër informata për AFK-n ju lutem vizitoni <http://www.afkonline.org/>



Agjencioni për Financim në Kosovë  
Agency for Finance in Kosovo  
Agencija za Finansiranje na Kosovu



**GREEN FOR GROWTH FUND**  
**SOUTHEAST EUROPE**

INVESTING IN ENERGY EFFICIENCY  
AND RENEWABLE ENERGY

#### **Media contact GGF**

Eric Culp

Press Officer

Phone: +49 (0)69/271 035-307

E-mail: [press@ggf.lu](mailto:press@ggf.lu)

#### **AFK kontakti per media**

Lyra Rezniqui Kryeziu

Menaxhere e Marketingut

Phone: +377 44 222215

E-mail: [LKryeziu@afkonline.org](mailto:LKryeziu@afkonline.org)